

Përmbledhje

- Në tremujorin e fundit të vitit 2022, ekonomia e eurozonës ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.1 përqind, ndikuar kryesisht nga dobësimi i kërkesës së brendshme si pasojë e rënies së të hyrave reale të ekonomive familjare dhe rritjes së kostos së prodhimit. Për dallim prej tremujorit të kaluar, çmimet e energjisë u karakterizuan me rënie si pasojë e rënies së kërkesës për gaz natyror, kushteve të mira klimatike por edhe masave të ndërmarra qeveritare për të nxitur kursimin e gazit dhe energjisë. Megjithë dinamikat në çmimet e energjisë, shkalla e inflacionit në eurozonë ka vazhduar të jetë e lartë edhe në fund të vitit, duke shtyrë BQE-në të rrisë sërish normën bazë të interesit. Projektionet e fundit të BQE-së sugjerojnë rritje të ngadalëshme ekonomike në 2023, ndikuar nga çmimet e larta dhe shtrëngimi i politikës monetare. Edhe Ballkani Perëndimor, që ka për partner tregtar të rëndësishëm eurozonën, është ndikuar nga dinamikat e përgjithshme makroekonomike në eurozonë dhe në tregjet financiare ndërkombëtare.
- **Rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV) në Kosovë në TM4 2022 ishte më e lartë krahasuar me tremujorin paraprak.** Konsumi privat, eksporti i mallrave dhe shërbimeve si dhe rënia e importit të mallrave kontribuuan pozitivisht në rritjen reale ekonomike, ndërkaq ndikim negativ patën rënia e investimeve dhe rritja e importit të shërbimeve. Bazuar në të dhënat tremujore, vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë se Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 3.5 përqind në vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 parashikimet e BQK-së sugjerojnë për rritje reale ekonomike prej 3.9 përqind. Rritja e aktivitetit ekonomik gjatë këtij viti pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme si dhe eksporti neto.
- **Buxheti i Kosovës në TM4 2022 shënoi deficit buxhetor,** si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat, ndërsa borxhi publik ra në 20.7 përqind të BPV-së.
- **Çmimet në vend** vazhduan të rriten krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërkohë që shkalla e inflacionit vazhdoi me rritje dyshifrore përgjatë vitit, kundrejt tremujorit paraprak presionet inflacioniste në vend u lehtësuan në TM4 2022, kryesisht si rezultat i dinamikave pozitive në çmimet në tregjet ndërkombëtare, kushteve të lehta klimatike dhe ndikimit rezultues në uljen e konsumit të energjisë elektrike, ngadalësimit të kërkesës së brendshme dhe përkeqësimit të perspektivës për aktivitet ekonomik global. Rritja e çmimeve vazhdoi të nxitet nga çmimet e ushqimit dhe energjisë, që përbëjnë shkallën më të madhe të shportës së konsumatorit në vend. Ndonëse shkalla e inflacionit shënoi ngadalësim krahasuar me tremujorin paraprak, inflacioni bazë ndoqi prirje ngritëse duke dhënë indikacione se mund të mos ketë arritur pikun akoma. Indekset e çmimeve të importit, prodhimit, dhe ai i kostos së ndërtimit po ashtu u lehtësuan krahasuar me tremujorin paraprak, por që kundrejt tremujorit të fundit të vitit paraprak akoma mbeten të larta, me përjashtim të indeksit të çmimeve të prodhimit i cili rezultoi në ngadalësim të dukshëm edhe në terma vjetorë.
- **Buxheti i Kosovës shënoi bilanc primar buxhetor pozitiv,** si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet, ndërsa borxhi publik ra në 20.7 përqind të BPV-së.
- **Llogaria rrjedhëse ka shënuar bilanc negativ prej 412.0 milionë euro në TM4 2022, dinamikë që kryesisht është përcaktuar nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave.** Bilanci i mallrave thelloi deficitin tregtar, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që edhe bilanci i të ardhurave parësore shënoi bilanc negativ. Në anën tjetër, bilanci i shërbimeve dhe të hyrat dytësore ndikuan në tkurrjen e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, një ndër burimet më të rëndësishme financuese të konsumit, remitancat, shënuan rritje të ngadalësuar prej 9.1 përqind, duke arritur në 318.3 milionë euro apo 12.9 përqind e BPV-së.
- **Sistemi financiar** është karakterizuar me qëndrueshmëri dhe pa ndonjë rrezik të materializuar gjatë TM4 2022, përkundër shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik, presioneve inflacioniste dhe pasigurive të rritura në tregjet ndërkombëtare.
 - **Sektori bankar** ka arritur të mbaj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit si dhe të mirëmbajë nivel të ulët të kredive jo performuese, gjë që rezultoi në jetë përkthyer në rritje të kapacitetit absorbues të sektorit ndër vite. Ndërkohë që vlerësohet se shkalla e lartë e inflacionit përgjatë gjithë vitit ka ndikuar në uljen potenciale të të ardhurave të disponueshme në ekonomi, duke rrezikuar potencialisht kapacitetin ripagues të huamarrësve (rritje potenciale e rrezikut kreditor) dhe dekurajuar kursimet (rrezikun e likuiditetit). Në tremujorin e katërt të vitit 2022, vlera e kredive jo-performuese filloi të rritej, kundrejtë dy viteve të fundit që ishte në trend rënës. Në TM4 2022, aktiviteti kreditues ishte kontribuuesi kryesor pozitiv në rritjen e aseteve të sistemit financiar, përderisa investimet në letrat me vlerë shënuan ngadalësim të rritjes. Pasiguria e shtuar nga rritja e çmimeve në vend dhe globalisht dhe reagimi i politikave monetare me rritjen e normave bazë të interesit në luftën ndaj inflacionit, ishin zhvillime që përkuan me rritjen e rrezikut për financim dhe rrjedhimisht, me rritjen normave të interesit në kredi dhe me intensitet relativisht më të lartë, të rritjes së normave të interesit në depozita.
 - **Sektori pensional** shënoi ngadalësim të rritjes dhe rënie të kthimeve nga investimet krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e dinamikave jo të favorshme në tregjet financiare ndërkombëtare. Përderisa kthimi kumulativ për gjithë vitin ishte negativ, ndryshimi filloi të ndodhë në tremujorin e katërt, përgjatë të cilit u realizua performancë e mirë, e cilësuar me rritje të vlerës së investimeve
 - **Sektori i sigurimeve** u karakterizua me nivel të përafërt të rritjes së aseteve me vitin paraprak, të favorizuar nga niveli i lartë i primeve të arkëtuara. Megjithatë, rritja e dëmeve të ndodhura dhe shpenzimeve operacionale rezultoi në një performancë financiare më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Me rritje të përshpejtuar të aseteve u karakterizua **sektori mikrofinanciar**, atribuar kryesisht rritjes së aktivitetit kreditor. Indikatorët e shëndetit financiar gjithashtu tregojnë për stabilitet të sektorit në përgjithësi, ndërkohë që rezultati financiar rezultoi të jetë më i larti që nga konsolidimi i sektorit. Në periudhat në vijim, dinamikat e rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare pritet të reflektohen në rritjen e kostove të financimit për sektorin mikrofinanciar.

Përmbajtja

Përmbledhje	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	2
Ballkani Perëndimor	2
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	3
Rritja Ekonomike	5
Çmimet	6
Sektori Fiskal	9
Sektori i jashtëm	9
Sistemi financiar	14
1. Sektori bankar	14
Kreditimi	15
1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake	17
1.2 Normat e interesit	18
Sektori pensional	22
Sektori i sigurimeve	23
Sektori mikrofinanciar	24
Kreditë	25
Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës	28

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e eurozonës shënoi rritje reale prej 0.1 përqind në tremujorin e fundit të vitit 2022, sipas Eurostat, një rritje më e ngadalësuar megjithatë pozitive marrë parasysh pritjet për recesion të mundshëm. Rritja më e ngadalshme ekonomike në eurozonë në TM4 2022 kryesisht u ndikua nga rënia e të hyrave reale të ekonomive familjare dhe rritja e kostos së prodhimit – që u përkthye në ngadalësim të shpenzimeve konsumatore dhe aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Ekonomia më e madhe në eurozonë, Gjermania, ka shënuar rënie të aktivitetit ekonomik prej 0.4 përqind si pasojë e rënies së evidentuar në komponentën e investimeve dhe ngadalësimit të eksportit me zvogëlimin e kërkesës së jashtme. Pritjet për recesion në muajt e fundit të vitit u zbehën, kryesisht si rezultat i kushteve më të mira klimatike dhe temperaturave më të larta që pasuan gjatë dimrit, si dhe masave incentivizuese nga qeveritë kundrejt kursimit të gazit dhe energjisë elektrike. Rritja ekonomike e ngadalësuar në Evropë u ndikua gjithashtu edhe nga aktiviteti i reduktuar në Kinë, si partner i rëndësishëm tregtar, ekonomi që është nën kufizime të ashpra COVID-19. **Projeksionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE janë rishikuar në mars kundrejt projeksioneve të dhjetorit, në 1.0 përqind për vitin 2023 dhe 1.6 përqind për vitin 2024.**

Shkalla e inflacionit në TM4 2022 ka vazhduar trendin e rritjes duke arritur në 9.9 përqind (9.6 përqind në TM3 2022), e ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve. Në dhjetor 2022, për herë të katërt brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit kur edhe ndryshoi kahu i politikës monetare pas 11 vjetësh, BQE-ja rriti normën bazë të interesit për 0.5 pikë bazë duke arritur nivelin prej 2.5 përqind. Për më tepër, rritja e normave të interesit do të vazhdojë edhe në vitin 2023, sipas ECB-së, deri në normalizimin e çmimeve dhe frenimin e inflacionit. Shkalla e inflacionit për vitin 2022 ishte 8.4 përqind, ndërsa projeksionet e BQE-së sugjerojnë një rënie të inflacionit në 5.3 përqind në 2023 dhe 2.9 përqind në vitin 2024.

Dinamikat në çmimet dhe konsumin e energjisë dhe gazit mbeten faktor të rëndësishëm në përcaktimin e zhvillimeve edhe përgjatë vitit 2023, ndërkohë që TM4 2022 u karakterizua me rënie të kërkesës, ndikuar nga dimri i butë, politikat stimuluese për kursim të energjisë dhe gazit nga qeveritë dhe ngadalësimi i aktivitetit industrial. Megjithatë, rimbushja e inventarëve të gazit për muajt e ardhshëm vlerësohet sfiduese, veçanërisht pasi që ekonomia e Kinës rihapet në vitin 2023, dhe pritjet të rrisë kërkesën për importe të gazit natyror të lëngshëm (LNG). Për më tepër, vazhdimësia e pasigurive gjeopolitike, dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe pasojat në aktivitetin e përgjithshëm global mbesin faktor me ndikim potencial në rritjen reale të BPV-së në eurozonë përgjatë vitit 2023..

Ballkani Perëndimor

Deri në shtator 2022, BPV-ja reale nga vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar rritje të lehtë prej 2.7 përqind, e ndikuar nga ngadalësimi i rritjes ekonomike në eurozonë dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e larta në energji dhe ushqime rritën presionet inflacioniste në të gjitha vendet e rajonit, duke ulur fuqinë blerëse dhe shpenzimet konsumatorë dhe ngadalësuar kërkesën e përgjithshme. **Projeksionet e FMN-së sugjerojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor pritjet të shënojnë një rritje ekonomike prej 3.4 përqind në vitin 2022 dhe 2.6 përqind në 2023.**

Shkalla mesatare e inflacionit në TM4 2022 në vendet e rajonit rezultoi të ketë qenë 14.5 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Maqedoninë e Veriut prej 18.7 përqind dhe në Mal të Zi prej 17.2 përqind, ndërsa Shqipëria shënoi normën më të ulët të inflacionit prej 7.9 përqind. Në përpjekje për të luftuar inflacionin në rritje, Bankat Qendrore në vendet e rajonit kanë rritur normën bazë të interesit në TM4 2022. Në nëntor 2022, Shqipëria rriti normën bazë për 0.5 pikë përqindje duke arritur në 2.75 përqind, ndjekur nga Maqedonia e Veriut që poashtu rriti normën bazë për 0.5 pikë përqindje në 4.75 përqind, dhe Serbia rriti normën bazë prej 0.5 pikë përqindje duke arritur në 5.0 përqind.

Në TM4 2022, tregu i këmbimit valutor i euros kundrejt valutave të partnerëve tregtar u vlerësua për 1.6 përqind ndaj sterlinës britanike, 5.1 përqind kundrejt lirës turke dhe 1.3 përqind ndaj dollarit amerikan. Vlera e valutës euro mbeti pothuajse e njëjtë ndaj lekut shqiptar, dinarit serb, dhe denarit maqedonas.


Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Presionet inflacioniste në çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare u lehtësuan në TM4 2022, kryesisht si rrjedhojë e përkeqësimit të perspektivës së aktivitetit ekonomik global dhe lehtësimit të pengesave në zingjirët e furnizimit. Sidoqoftë, çmimet e mallrave të ndryshme ndoqën trajektore të ndryshme, varësisht nga ndikimi lehtësues i rënies së kërkesës për mallra të caktuara dhe dinamikat në anën e ofertës.

Çmimet e naftës së papërpunuar Brent sipas Bankës Botërore arritën mesatare prej \$88.4 për fuçi në TM4 2022, që përbën rritje vjetore prej 11.0 përqind (\$79.6 për fuçi në TM4 2021) (grafik 1). Sidoqoftë, në raport me tremujorin paraprak, çmimet e naftës shënuan rënie prej 10.9 përqind (\$99.2 për fuçi në TM3 2022). Në terma mujorë, rritje e çmimit të naftës u evidentua në tetor, pas vendimit të vendeve të OPEC+ për të reduktuar sasinë e prodhimit të naftës për 2 milionë fuçi në ditë nga nëntori. Ndërsa, në nëntor dhe dhjetor çmimet e naftës ndoqën trend rënës ndikuar nga ngadalësimi i rritjes ekonomike globale, vazhdimi i kufizimeve të ndërlidhura me kontrollin e pandemisë në Kinë si dhe shfrytëzimi i rezervave strategjike të naftës në shumë vende që ndikuan në rënien e kërkesës për naftë. Rreziqet që përcjellin perspektivën e çmimeve të naftës nga kahu i poshtëm përfshijnë rrezikun e një recesioni global që do të ndikonte në rënien e mëtejshme të kërkesës, ndërsa rreziqet nga kahu i lartë kryesisht ndërlidhen me pengesa dhe reduktime potenciale të ofertës.

Çmimet e gazit natyror në Evropë që arritën kulmin në gusht 2022 si pasojë e reduktimit të sasisë së furnizimit me gaz natyror nga Rusia dhe blerjes masive të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) nga ana e BE-së për të rimbushur stoqet para dimrit, u lehtësuan dukshëm në TM4 2022 duke shënuar rënie prej 38.7 përqind në \$36.9/mmbtu nga \$60.2/mmbtu në TM3 2022. Rënia e çmimeve të gazit natyror në TM4 2022 u mbështet nga furnizimi me gaz natyror nga Norvegjia dhe me GNL nga SHBA-të, që ndihmuan në mbushjen e rezervave deri në 90 përqind të kapacitetit, duke zvogëluar kështu

Grafik 1. Çmimet e energjisë në tregjet ndërkombëtare



shqetësimet rreth problemeve potenciale në furnizim me gaz natyror. Për më shumë, çmimet u ndikuan edhe nga rënia e kërkesës për gaz natyror për shkak të konsumit më të ulët të energjisë elektrike për ngrohje nga amvisëritë si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë dhe kushteve të lehta klimatike gjatë TM4 2022, si dhe nga mbyllja e disa fabrikave në Evropë me prodhim të bazuar në përdorim intensiv të energjisë. Për më shumë, ndikim në rënien e çmimeve të gazit natyror patën edhe politikat e ndërmarra nga BE për zvogëlim të konsumit të gazit natyror dhe diversifikim të miksit energjetik me fokus në burime të ripërtëritshme. Përkundër lehtësimeve të fundit, çmimet e gazit natyror në TM4 2022 ishin më të larta sesa ato të vitit paraprak duke shënuar rritje vjetore prej 14.6 përqind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Ngjashëm, lehtësim u evidentua edhe në çmimet e thëngjillit në TM4 2022, me çmimet e thëngjillit australian dhe atij nga Afrika e Jugut që shënuan rënie prej 10.4 dhe 32.8 përqind respektivisht krahasuar me tremujorin paraprak. Çmimet e thëngjillit në tregje ndërkombëtare u ngritën gjatë TM3 2022, si pasojë e rritjes së përdorimit të thëngjillit për gjenerim të energjisë elektrike pas rritjes së çmimeve të gazit natyror. Kjo ndikoi në rritjen e prodhimit të brendshëm të thëngjillit në shumë vende, për të reduktuar varësinë nga importi, duke

rritur kështu ofertën që rrjedhimisht u pasqyrua në rënie të çmimeve të thëngjillit. Sidoqoftë, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, edhe çmimet e thëngjillit ishin më të larta në TM4 2022 me rritje vjetore prej 101.4 përqind në çmimet e thëngjillit australian dhe 11.3 përqind në çmimet e thëngjillit nga Afrika e Jugut.

Dinamikat në çmimin e gazit natyror në Evropë u reflektuan edhe në çmimet e plehut artificial në TM4 2022 marrë parasysh përdorimin intensiv të energjisë në prodhimin e plehut artificial. Plehurat artificiale DAP, TSP, dhe urea shënuan rënie mesatare vjetore të çmimit prej 10.3 përqind krahasuar me tremujorin paraprak ndikuar nga kërkesa më e ulët si pasojë e rritjes së çmimeve dhe nga vazhdimi i importimit të plehut artificial rus në BE që përbën përjashtim nga sanksionet e vendosura me qëllim të ruajtjes së sigurisë së furnizimit. Në anën tjetër, çmimet e kloridit të potasiumit vazhduan të mbeten të larta si pasojë e embargos së vendosur nga BE ndaj Bjellorusisë që i ndaloi kësaj të fundit eksportet në BE dhe përdorimin e territorit të BE-së për transport të mallrave.

Presionet inflacioniste në çmimet e ushqimit gjithashtu u lehtësuan në TM4 2022, me indeksin e ushqimit sipas Bankës Botërore që shënoi rënie prej 0.2 përqind në terma nominalë në raport me TM3 2022, si rezultat i rritjes së ofertës së vajrave ushqyese, marrëveshjes mes Ukrainës dhe Rusisë për lejimin e eksportimit të rezervave ukrainase të drithërave, si dhe përkeqësimit të perspektivës për aktivitetin ekonomik global që ndikoi kërkesën e përgjithshme. Në shumë vende, çmimet e ushqimit përkundër lehtësimeve në TM4 2022 vazhduan të përkeqësohen si pasojë e zhvlerësimit të valutave. Sidoqoftë, në nivel global indeksi i çmimeve të ushqimit në TM4 2022 qëndroi 8.8 përqind më lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2021, si pasojë e rritjes së çmimit të drithërave për shkak të rënies së prodhimit, ndërsa rënie vjetore u evidentua në çmimet e vajrave ushqyese. Perspektiva e çmimeve të ushqimit vazhdon të minohet nga një kombinim rreziqesh si rritja potenciale e çmimit të inputeve, pengesat në zingjirët e furnizimit, politikat tregtare, përkeqësimi i perspektivës së aktivitetit ekonomik global, kushtet klimatike, e të tjera.

Indeksi i çmimeve të metaleve bazë shënoi rënie vjetore prej 13.8 përqind në TM4 2022 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak si pasojë e rritjes së ngadalësuar të ekonomisë globale dhe masave kufizuese për luftimin e pandemisë në Kinë. Në raport me tremujorin paraprak çmimet e metaleve treguan prirje ngritëse duke u rritur për 2.1 përqind në TM4 2022. Ndonëse, çmimet e metaleve shënuan rënie në tetor si pasojë e përkeqësimit të perspektivës së aktivitetit ekonomik global, ato u ngritën në nëntor dhe dhjetor pas lehtësimit të masave kufizuese të pandemisë në Kinë dhe politikave lehtësuese të financimit në sektorin e ndërtimit dhe patundshmërive.

Ekonomia e Kosovës

Rritja Ekonomike


Aktiviteti ekonomik në Kosovë, sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shënoi rritje reale prej 3.6 përqind në TM4 2022. Kërkesa e brendshme kontribuoi negativisht në rritjen reale të BPV-së me 2.3 pikë përqindje, ndërkaq eksportet neto kontribuan pozitivisht me 5.8 pikë përqindje dhe kundrejt tremujorit paraprak përbën përshejtim të dukshëm (grafik 2).

Konsumi kontribuoi me 1.0 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së e që krahasuar me tremujorët paraprak është një kontribut më i ulët. Në ngadalësimin e rritjes së konsumit ka ndikuar ngadalësimi i rritjes së burimeve kryesore të financimit si kompensimi i punëtorëve, remitancave, rënia e kredive të reja konsumuese, rënia e konsumit publik, si dhe rënia e fuqisë blerëse të konsumatorëve për shkak të rritjes së çmimeve. Investimet kontribuan negativisht me 3.3 pikë përqindje në BPV-në reale, kryesisht si pasojë e rënies së kredive të reja investuese, si dhe ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në sektorin e ndërtimit. Sa i përket tregtisë së jashtme, eksportet neto kontribuan pozitivisht me 5.8 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, me eksportin e mallrave dhe shërbimeve që shënoi rritje reale për 9.5 përqind dhe importin që shënoi rënie për 5.0 përqind.

Rritja e aktivitetit ekonomik në TM4 2022 është mbështetur kryesisht nga rritja në sektorin e industrisë përpunuese (12.5 përqind), aktiviteve financiare dhe të sigurimit (11.5 përqind), aktiviteve shkencore, profesionale dhe teknike (9.8 përqind), etj. Edhe sektori i tregtisë, si njëri ndër sektorët kryesorë, ka shënuar rritje reale të vlerës shtuar prej 6.9 përqind në TM4 2022 e që është një rritje më e ulët krahasuar me rritjen prej 19.7 përqind në TM4 2021. Mirëpo, për shkak të rritjes së çmimeve, mesatarja e indeksit të qarkullimit në sektorin e tregtisë është rritur për 38.1 përqind. Në anën tjetër, rënia më e lartë e vlerës së shtuar është shënuar në sektorin e ndërtimit (11.8 përqind). Rënia e aktivitetit ekonomik në këtë sektor në masë të madhe i atribuohet rritjes së kostos së ndërtimit prej 16.6 përqind në TM4 2022, gjë që ka ndikuar në shtyrjen e projekteve investuese në këtë sektor.


Aktiviteti ekonomik u pasqyrua edhe në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara, që arriti në 2,636 ndërmarrje në TM4 2022, gjegjësisht 9.1 përqind më shumë krahasuar me TM4 2021. Numër më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara u shënuar në sektorin e tregtisë, ndërtimit, prodhimit, aktiviteve profesionale, hoteleri, etj. Ndërsa, sektorët të cilët regjistruan më shumë ndërmarrje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 ishin sektori i ndërtimit, bujqësisë, furnizimit me energji elektrike, aktiviteve profesionale, etj. (grafik 3).

Grafik 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Grafik 3. Numri i ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK.

Në anën tjetër, gjatë TM4 2022, u mbyllën 457 ndërmarrje apo 38.9 përqind më shumë krahasuar me TM4 2021.

Vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë se Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 3.5 përqind në vitin 2022 dhe këto dinamika pritet të vazhdojnë edhe në vitin 2023. **Parashikimet e BQK-së sugjerojnë për rritje reale ekonomike prej 3.9 përqind.** Rritja e aktivitetit ekonomik gjatë këtij viti pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme si dhe eksporti neto. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 2.3 përqind ndërsa rritja nominale pritet të jetë 7.9 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave, kompensimi i punëtorëve, rritja e kredive konsumuese si dhe rritja e konsumit publik. Investimet në vitin 2023 parashihet të shënojnë rritje reale prej 3.6 përqind (7.3 përqind rënie në vitin 2022). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve pritet të ketë kreditimi bankar si dhe rritja e investimeve publike. Eksportet neto pritet të ulin deficitin tregtar për 1.6 përqind në terma real, si rezultat i rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve për 14.5 përqind.

Çmimet

Shkalla vjetore e inflacionit në TM4 2022 arriti në 12.1 përqind, kundrejt 6.4 përqind sa ishte në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, rritja vjetore e shkallës së inflacionit në TM4 krahasuar me tremujorin paraprak rezultoi në këtë shënuar ngadalësim (13.3 përqind në TM3 2022), që mund t'i atribuohet ngadalësimit të kërkesës së brendshme pas rëndimit të inflacionit mbi fuqinë blerëse, kushteve klimatike dhe politikave të ndërmarrja për kursim të energjisë që ndikuan në rënien e konsumit të energjisë elektrike krahasuar me TM4 2021, si dhe dinamikave pozitive që ndikuan në rënie të çmimeve të energjisë dhe ngadalësim të çmimeve të ushqimit në tregjet ndërkombëtare. Marrë parasysh peshën e konsiderueshme të mallrave ushqimore dhe energjetike në shportën e konsumatorit në Kosovë (46.7 përqind), çmimet e ushqimit dhe karburanteve në tregjet ndërkombëtare mbetën nxitësit kryesorë të inflacionit në TM4 2022 duke u transmetuar në çmimet vendore përmes importit.


Ndonëse u evidentua ngadalësim në çmimet e mallrave ushqimore që shënuan rritje vjetore prej 18.7 përqind në TM4 2022 krahasuar me 19.5 përqind në tremujorin paraprak, ato vazhduan të mbeten të larta krahasuar me inflacionin e ushqimit në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar që ishte 6.3 përqind. Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rritja më e lartë vjetore u evidentua në çmimet e vajrave dhe yndyrave prej 36.0 përqind, qumështit, djathit dhe vezëve (26.5 përqind), bukës dhe drithërave (24.2 përqind), mishit (21.4 përqind), e të tjera. Në përgjithësi, me përjashtim të frutave, të gjitha mallrat ushqimore në shportën e konsumit shënuan rritje mesatare vjetore të çmimeve më të lartë se 7.0 përqind.

Çmimet e energjisë elektrike dhe lëndëve tjera djegëse në kuadër të kategorisë së strehimit shënuan rritje mesatare vjetore prej 18.4 përqind në TM4 2022, që përbën përshpejtim të konsiderueshëm krahasuar me TM4 2021 kur kjo kategori rezultoi me inflacion prej 5.9 përqind. Përderisa të dhënat nga ASK rreth konsumit të energjisë elektrike tregojnë për rënie të konsumit të energjisë elektrike prej 7.6 përqind krahasuar me TM4 2021 si rezultat i kushteve të lehta klimatike dhe rënies së konsumit nga amvisëritë për ngrohje, ngritja e çmimeve në këtë kategori kundrejt TM4 2021 kryesisht i atribuohet rritjes së çmimit me shumicë të energjisë elektrike në tregjet e huaja në TM4 2022. Përveç kushteve klimatike ndikim në rënien vjetore të konsumit të energjisë elektrike në TM4 2022 patën edhe politikat e ndërmarrja nga Qeveria si subvencionimi i faturave të energjisë elektrike për amvisëritë me konsum nën 800 kWh, subvencionimi i blerjes së pajisjeve më eficiente për ngrohje për amvisëritë, zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike për ndriçim publik dhe përdorim në institucione publike, e të tjera. Ndërsa, krahasuar me TM3 2022, në TM4 u evidentua rritje e konsumit të energjisë elektrike si pasojë e rënies së temperaturave dhe rritjes së përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje që rezultoi në rritje të çmimit për amvisëritë me konsum mbi 800kWh për shkak të kalimit të bllok-tarifës. Rrjedhimisht, si pasojë e rritjes së çmimeve me shumicë të energjisë elektrike në tregjet e huaja dhe

rritjes së konsumit gjatë TM4 2022, indeksi i energjisë elektrike në TM4 2022 shënoi rritje mesatare prej 6.1 përqind krahasuar me tremujorin paraprak. Rritje e çmimeve u evidentua edhe në çmimet e lëndëve djegëse të ngurta që shënuan rritje vjetore prej 46.4 përqind, ndërsa në raport me tremujorin paraprak shënuan rritje prej 9.0 përqind.

Çmimet e transportit shënuan rritje vjetore prej 10.9 përqind në TM4 2022, me kategorinë e përdorimit të pajisjeve për transport personal që regjistroi rritje të lartë të çmimeve prej 15.6 përqind, e cila pastaj u përkthye në rritjen e çmimit të shërbimeve të transportit në 14.3 përqind. Ndërsa, në baza tremujore, çmimet e transportit shënuan ngadalësim të rritjes prej 7.3 pikë përqindje, nga shkalla prej 18.2 përqind në TM3 2022, kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare.

Grafik 4. Kontributi i nëngrupeve përkatëse në IÇK




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit ishte 6.9 pikë përqindje, me kontributin më të lartë të shënuar nga rritja e çmimeve të bukës dhe drithërave prej 2.2 pikë përqindje, mishit prej 2.0 pikë përqindje, dhe qumështit, djathit dhe vezëve prej 1.5 pikë përqindje. Ndërsa, sa i përket kategorisë së transportit ku përfshihet pjesa më e madhe e karburanteve, kontributi i transportit në gjithsej inflacionin e përgjithshëm në TM4 2022 ishte 1.7 pikë përqindje, e që u gjenerua kryesisht nga nënkategoria përdorimi i pajisjeve për transportin personal me kontribut prej 1.2 pikë përqindje (grafik 4).

Lehtësimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare u reflektuan edhe në çmimet e mallrave tjera (mallrat përjashtuar ushqimin dhe energjinë) dhe shërbimeve, me kontributin e mallrave që mbeti i njëjtë me tremujorin paraprak (1.2 pikë përqindje) ndonëse me prirje ngritëse nga dhjetori, dhe me kontributin e shërbimeve që u zvogëlua për 0.1 pikë përqindje (nga 1.5 pikë përqindje në TM3 2022) e që po ashtu tregoi trend ngritës si pasojë e përshpejtimit të çmimeve të shërbimeve të transportit në dhjetor 2022.

Inflacioni bazë në TM4 2022 shënoi rritje vjetore prej 5.7 përqind, e që kundrejt tremujorit paraprak, paraqet ngadalësim prej 0.3 pikë përqindje (grafik 5). Sidoqoftë, ngritja e evidentuar e inflacionit bazë në muajin dhjetor jep indikacione se inflacioni bazë mund të mos ketë arritur pikun akoma, me luhatjet që i atribuohen kryesisht çmimeve të shërbimeve veçanërisht

Grafik 5. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

atyre të transportit, dhe çmimeve të mallrave tjera (përjashtuar ushqimin dhe pijet joalkoolike, pijet alkoolike dhe duhanin, dhe energjinë).

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe shkalla e lartë e pjesëmarrjes së këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që shkalla e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet mallrave të importuara. Në TM4 2022, 10.4 pikë përqindje të inflacionit në Kosovë ishte importuar, ndërsa 1.7 pikë përqindje u gjenerua nga presionet e brendshme inflacioniste (grafik 6). Si rezultat i lehtësimeve të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, inflacioni i importuar në TM4 2022 tregon për ngadalësim kundrejt tremujorit paraprak, që rrjedhimisht u pasqyrua edhe në frenimin e inflacionit të brendshëm.

Grafik 6. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Luhatjet e çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, të pasqyruara në Kosovë përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara, përmbledhen përmes indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) i cili në TM4 2022 shënoi rritje prej 13.1 përqind krahasuar me TM4 2021. Në raport me tremujorin paraprak IÇIMP shënoi rritje prej 0.9 përqind, si pasojë e përshpejtimit të çmimeve të i) letrës dhe artikujve përkatës, ii) drurit dhe artikujve të drurit, iii) produkteve bimore, e të tjera. Në anën tjetër, u evidentua ngadalësim i çmimeve të i) produkteve minerale, ii) plastikës, kauçikut dhe artikujve përkatës, iii) metaleve bazë dhe artikujve përkatës, iv) vajrave ushqyese.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) rezultoi në ngadalësim të theksuar në 0.6 përqind në TM4 2022 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, kundrejt tremujorit paraprak IÇP rezultoi me rënie prej 13.7 përqind kryesisht si rezultat i rënies prej 42.8 përqind në çmimet e prodhimit të energjisë elektrike, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar, rënies prej 1.4 përqind në çmimet e prodhimit të produkteve minerale jometalike, dhe rënies prej 0.2 përqind në çmimet e përpunimit të produkteve ushqimore, kategori këto që përbëjnë më shumë se gjysmën e peshës brenda këtij indeksi.

Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) shënoi rritje vjetore prej 16.7 përqind në TM4 2022, nxitur nga rritja e çmimeve të materialeve ndërtimore që përbëjnë 60.4 përqind të IKN dhe që shënuan rritje vjetore prej 17.6 përqind, transportit (40.4 përqind rritje vjetore), makinerive (17.7 përqind), e të tjera. Ndërsa, përshpejtimi i këtij indeksi u neutralizua pjesërisht nga rënia e çmimeve të energjisë në TM4 2022 (-15.2 përqind) krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Në raport me tremujorin paraprak u vërejt rënie e IKN prej 0.6 përqind kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të materialeve ndërtimore prej 0.3 përqind dhe energjisë prej 42.8 përqind.

Lidhur me perspektivën e inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në vitin 2023 të ngadalësohet në 5.4 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë lehtësimet e vazhdueshme të pengesave në zingjirët e furnizimit, trendin zbritës të inflacionit në eurozonë, transmetimin e shtrëngimit të

kushteve të financimit në kërkesën e brendshme, e të tjera. Sidoqoftë, rreziqet e ndërlidhura me inflacionin vazhdojnë të anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa të reja në zingjirët e furnizimit si pasojë e luftës në Ukrainë, rritja potenciale e çmimeve të energjisë, metaleve bazë, dhe mallrave tjera nga rihapja e ekonomisë së Kinës, zhvendosja e pritjeve të konsumatorëve për inflacionin, presionet për rritje të pagave, e të tjera.


Sa u përket pritjeve të bankave për inflacion vjetor në Kosovë për vitin 2022, këto janë rritur në 11.0 përqind në TM4 2022 nga pritjet për inflacion vjetor prej 9.7 përqind në TM3 2022. Ndërsa, pritjet për inflacion në tremujorin e ardhshëm u ngritën në 11.3 përqind nga 10.3 përqind në TM3 2022. Ndonëse pritjet e bankave për inflacionin kanë ndjekur trend rritës, ato mbesin nën vlerat faktike të inflacionit të përgjithshëm.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ në TM4 2022 arritën vlerën neto prej 640.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.9 përqind. Rritja e të hyrave buxhetore ishte kryesisht rezultat i normës së lartë të inflacionit, që afektoi kryesisht tatimet indirekte, si kategoria kryesore e të hyrave buxhetore, si dhe përpjekjeve të ndërmarra për formalizimin e ekonomisë, përmes formalizimit të punësimit si dhe rritjes së kontrolleve dhe inspektimeve në teren. **Edhe shpenzimet buxhetore² shënuan rritje prej 18.9 përqind dhe arritën vlerën prej 942.7 milionë euro, nxitur kryesisht nga realizimi i shpenzimeve në formë të subvencioneve dhe transfereve në kuadër të masave për përballje me rritjen e inflacionit.** Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 301.8 milionë euro.

Në kuadër të të hyrave buxhetore, të gjitha kategoritë kanë shënuar rritje. Rritja më e lartë është shënuar te të hyrat tatimore direkte, të cilat arritën vlerën prej 100.0 milionë euro apo 18.9 përqind më shumë krahasuar me TM4 2021. Në kuadër të kësaj kategorie, tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 25.8 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat personale si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje vjetore prej 15.2 përqind. Të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 10.1 përqind dhe arritën vlerën 492.8 milionë euro. Në kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat nga TVSH-ja shënuan rritje prej 14.3 përqind duke u ndikuar dukshëm nga rritja e çmimeve. Ndërsa, përkundër rënies së sasisë së importit, të hyrat nga detyrimi doganor dhe akciza shënuan rritje prej 7.2 përkatësisht 1.9 përqind si rezultat i rritjes së çmimeve të mallrave të importuara. Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 4.4 përqind dhe arritën vlerën 67.1 milionë euro. Në kuadër të të hyrave jo-tatimore, të hyrat nga qeveria qendrore arritën vlerën prej 36.3 milionë euro duke shënuar rritje prej 6.0 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje për 8.2 përqind dhe arritën vlerën prej 17.2 milionë euro (grafik 7).

Grafik 7. Struktura e të hyrave tatimore



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

Sa u përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 14.6 përqind ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 31.9 përqind. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 21.2 përqind dhe arritën vlerën prej 365.5 milionë euro. Shpenzimet

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të pranimet nga financimi si dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim si dhe pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) shënuan rritje për 11.5 përqind dhe arritën vlerën 140.9 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje për 5.0 përqind dhe arritën vlerën prej 175.1 milionë euro. Shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 31.9 përqind dhe arritën vlerën prej 261.2 milionë euro. Gjatë këtij tremujori, shpenzimet kapitale përbënin 27.7 përqind të gjithë shpenzimeve buxhetore në krahasim me 25.0 përqind sa ishte në tremujorin e njëjtë të vitit 2021.

Raporti i borxhit ndaj BPV-së ishte 20.7 përqind në TM4 2022, krahasuar me 21.5 përqind në TM4 2021. Kjo ulje ishte si rezultat i përmirësimit të bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritjes së BPV-së nominale, e cila redukton raportin e borxhit ndaj BPV-së. Ky nivel i borxhit publik është larg pragut të paraparë me ligj prej 40 përqind e BPV-së si dhe larg mesatares së vendeve të rajonit prej rreth 60 përqind e BPV-së. Sidoqoftë, në terma absolut borxhi publik ka arritur në 1.75 miliardë euro në TM4 2022, që është për 4.2 përqind më i lartë krahasuar me TM4 2021. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm publik për 11.2 përqind duke arritur në 641.2 milionë euro, si dhe rritjes së borxhit të brendshëm publik prej 0.5 përqind që arriti në 1.1 miliardë euro. Borxhi i jashtëm përbëhet nga detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (34 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (16 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (8 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i brendshëm kryesisht përbëhet nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj fondeve pensionale (49 përqind), bankave komerciale (25 përqind), institucioneve publike (19 përqind), etj.

Sektori i jashtëm


Llogaria rrjedhëse në TM4 2022 ka shënuar bilanc negativ prej 412.0 milionë euro, që korrespondon me 16.7 përqind të BPV-së.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, bilanci negativ i llogarisë rrjedhëse ka shënuar rritje vjetore prej 11.0 përqind (371.0 milionë në TM4 2021) (grafik 8). Deficiti i llogarisë rrjedhëse në tremujorin e fundit të vitit 2022 ka vazhduar të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet e bilancit tregtar të mallrave, ndërkohë që edhe llogaria e të ardhurave parësore shënoi bilanc negativ. Ndërkohë në po të njëjtën periudhë kohore, shërbimet dhe të ardhurat dytësore vazhduan të kontribuojnë në zvogëlimin e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse.

Bazuar në të dhënat e ASK-së, bilanci tregtar i mallrave në Kosovë për TM4 2022 ka shënuar deficit tregtar prej 1.16 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 22.7 përqind.

Arsyeja kryesore e rritjes së deficitit tregtar ndërlihet nga vlera e lartë e importit të mallrave, vlerë që kryesisht reflekton rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe për pasojë, çmimet e importit (grafik 9). Në këtë tremujor, ekonomia e Kosovës ka importuar mallra në vlerë prej 1.49 miliard euro, ndërkohë që në të njëjtën periudhë, janë eksportuar mallra në vlerë prej

Grafik 8. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Grafik 9. Bilanci tregtar i mallrave



232 milionë euro. Eksportet kanë mbuluar vetëm 15.6 përqind të importeve, ku raporti tregtar qëndroi në 1:6.3.


Vlera e gjithsej eksporteve në TM4 2022 arriti në 232.4 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 11.5 përqind, rritje që kryesisht i'u atribua çmimeve në tregjet ndërkombëtare, por edhe rritjes së sasisë së eksportuar (sasia e mallrave shënoi rritje prej 4.1 përqind në TM4 2022) (grafik 10).

Struktura e mallrave dhe kompozicioni i mallrave të eksportuara mbeti e pandryshuar. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në TM4 2022 mbeten Ballkani Perëndimor me 36.3 përqind të gjithsej eksporteve, dhe vendet BE-së me 35.4 përqind. Ekonomia e Kosovës kryesisht rezulton të ketë eksportuar mallra të metaleve bazë, të destinuara kryesisht në vendet e rajonit, pasuar nga eksportet e produkteve të plastikës, përfshirë gomës dhe mineraleve, të eksportuara kryesisht në vendet e BE-së.

Duke arritur në 60.2 përqind të BPV-së, vlera e mallrave të importuara arriti në 1.49 miliard euro në TM4 2022, një rritje vjetore prej 12.5 përqind. Rritja e komponentës së importit i'u atribua kryesisht dinamikave të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, përderisa sasia dhe pesha e përgjithshme e importuar rezultojnë të kenë shënuar rënie prej 4.5 përkatësisht 14.5 përqind, ndikuar nga ngadalësimi i kërkesës së përgjithshme në vend.


Struktura e kategorive të mallrave të importuara mbeti e pandryshuar, me produktet minerale, artikujt ushqimorë dhe makineritë përfshirë pajisjet shtëpiake si kategoritë kryesore të importit (grafik 11). Ndërsa pjesëmarrja sipas kategorive kryesore u dominua nga kategoria e mallrave të ndërmjetme prej 50.7 përqind, mallrat konsumues 31.0 përqind, deri sa kategoria e mallrave kapitale vazhdon të mbetet e ulët prej 10.1 përqind e importit të përgjithshëm. Rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare kryesisht nga kategoria e ushqimeve dhe energjisë, potencialisht mund të ndikoj në rritjen e vlerës së importit të mallrave të ndërmjetme dhe të konsumit. Rreth 42.1 përqind e importeve të mallrave ka ardhur nga vendet të Bashkimit Evropian (625.5 milionë euro), ndër të cilat peshën kryesore vazhdon ta ketë Gjermania me 11.6 përqind të gjithsej importeve. Nga vendet e rajonit, Kosova importoi 17.7 përqind e importit të përgjithshëm, apo 262.3 milionë euro. Ndërkohë importi i mallra nga Turqia ka arritur në shume prej 262.1 milionë euro apo 17.6 përqind e gjithsej importeve.

Garfik 10. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.


Garfik 11. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.


Aktivitet nga shërbimet kanë shënuar bilanci pozitiv në TM4 2022, duke arritur vlerën prej 223.6 milionë euro, një rritje vjetore prej 59.0 përqind (grafik 12). Eksporti i shërbimeve shënoi rritje të theksuar, kryesisht nga rritja e shërbimeve në kategorinë e udhëtimit, duke shënuar rritje vjetore prej 24.6 përqind në vlerë prej 278.8 milionë euro në fund të periudhës, e që kishin pjesëmarrje prej 11.3 përqind në gjithësej BPV-në. Dinamikat në këtë kategori kryesisht reflektohen nga rritja e numrit të udhëtarëve, 44.7 përqind më shumë krahasuar me TM4 2021 (të dhënat nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës). Rritje në eksportin e shërbimeve rezultojnë të ketë shënuar edhe kategoria e shërbimeve kompjuterike me vlerë prej 58.2 milionë euro apo 66.9 përqind rritje vjetore, e ndikuar nga rritja e kërkesës së jashtme. Në anën tjetër, rritja e importit të shërbimeve i'u atribuara rritjes së komponentëve së udhëtimit dhe transportit, e që përbejnë 54.9 përqind të gjithësej importit, ndikuar nga çmimet e rritura të produkteve minerale në tregjet ndërkombëtare.

Grafik 12. Bilanci i shërbimeve



Burimi: BQK.

Grafik 13. Bilanci i të ardhurave parësore




Burimi: BQK.

Bilanci i të ardhurave parësore shënoi rënie prej 58.0 përqind, duke arritur vlerën prej 34.7 milionë euro (82.7 milionë euro TM4 2021) (grafik 13). Rënia e të ardhurave parësore u ndikua kryesisht nga bilanci i të ardhurave nga investimet, si pasojë e kthimit të dividendëve në vlerë prej 44.9 milionë euro nga investimet direkte. Ndërsa, bilanci i të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve ka shënuar rënie të lehtë prej 3.4 përqind, e ndikuar nga rënia e të hyrave nga punëtorët rezident jashtë vendit.

Vlera e remitencave të pranuar në TM4 2022 ka arritur në 318.3 milionë euro, rritje prej 9.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak (12.9 përqind e BPV-së) (grafik 14). Rritja e ngadalësuar e dërgesave të remitencave mund të jetë ndikuar nga shkalla e lartë e inflacionit në vendet ku jetojnë diaspora, duke ndikuar në tkurrjen e të hyrave të disponueshme apo rënien e të ardhurave reale. Struktura sipas shteteve mbetet e pa ndryshuar, ku prinë Gjermania (41.2 përqind e remitencave të dërguara), pasuar nga Zvicra (20.2 përqind) dhe SHBA-të (9.1 përqind). Dërgesat e emigranteve sipas kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) kanë shënuar rritje në vlerë prej 30.9 milionë euro, ndërsa është shënuar rritje e lehtë e

Grafik 14. Remitancat



Burimi: BQK.


dërgesave në kanale jo formale. Duke konsideruar që pjesa me e madhe të remitencave janë nga vendet e eurozonës (59.4 përqind), pasiguritë që shoqërojnë dinamikat të përgjithshme ekonomike por edhe pa siguria nga sektori dominues (sektori i ndërtimitarisë) ku është e fokusuar diaspora e Kosovës, mund të përkthehet në zvogëlim të këtij burimi të rëndësishëm financues.

Investimet e huaja direkte në TM4 2022 rezultojnë të kenë shënuar rritje prej 137.8 milionë euro dhe të kenë arritur vlerën prej 163.9 milionë euro (grafik 15). Rritja e IHD-ve

në Kosovë, në vitin 2022, është evidentuar kryesisht në sektorët e patundshmërisë, dhe xehetarisë (përfshirë guroret). Sektori i patundshmërisë mbulon 78.6 përqind e përgjithshme të IHD-ve apo 129.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 36.2 përqind. Rritja e IHD-ve në sektorin e patundshmërisë vlerësohet se u ndikua kryesisht nga rritja e kërkesës dhe pjesërisht ndikuar nga rritja e kostos të ndërtimit (16.7 përqind rritje në TM4 2022).

IHD e rezidenteve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rritje të lartë në TM4 2022, duke arritur vlerën prej 62.1 milionë euro (18.5 milionë euro në TM4 2021), investime te destinuar në vendet e rajonit e të orientuara kryesisht në sektorin e patundshmërisë.

Grafik 15. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Sistemi financiar

Sistemi financiar u karakterizua me zgjerim të theksuar të aktivitetit, përkundër rritjes së lartë të inflacionit, shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik si dhe luhatshmërive të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare.


Presionet e vazhdueshme inflacioniste kanë frenuar rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike pas-pandemike, duke rritur pasiguritë dhe ndjeshmërinë edhe të sistemit financiar. Asetet e sistemit financiar në vend ngadalësuan rritjen vjetore për 2.1 pikë përqindje, dhe vlera e tyre arriti në 9.9 miliardë euro. Ngadalësimi i trendit të rritjes u ndikua nga zhvillimet në sektorin pensional, përdërisa asetet e sektorëve tjerë shënuan përshejtim të rritjes (grafik 16).

Sektori bankar në dhjetor 2022 përfaqësoi 68.4 përqind të gjithë asetëve të sistemit financiar, duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e gjithë asetëve të sistemit financiar (grafik 17). Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të theksuar të aktivitetit, dhe përkundër peshës së ulët prej vetëm 4.1 përqind në gjithë asetet e sistemit, u radhit i dyti për nga kontributi në gjithë rritjen vjetore të asetëve. Sektori pensional u karakterizua me rënie të vlerës së investimeve, që u reflektua në ngadalësim të theksuar të trendit të rritjes së asetëve të këtij sektori dhe rrjedhimisht edhe në rënie e peshës/kontributit në rritjen e gjithë asetëve të sistemit financiar (grafik 17). Ndërsa sektori i sigurimeve dhe ndërmjetësve financiar, për shkak të peshës më të ulët, kishin ndikim më të kufizuar në strukturën e përgjithshme të asetëve të sistemit përkundër përshejtimit të rritjes gjatë kësaj periudhe.

1. Sektori bankar


Rreziqet për sektorin bankar nga zhvillimet jo të favorshme gjeopolitike dhe makroekonomike vijnë të jenë të larta, megjithatë në vitin 2022 këto rreziqe nuk u materializuan në mënyrë të konsiderueshme në aktivitetin dhe performancën e sektorit. Presionet e vazhdueshme inflacioniste vlerësohet të kenë ndikuar në rënie e të ardhurave të disponueshme në ekonomi, duke u përkthyer në rënie potenciale të kapacitetit ripagues të huamarrësve (rritje të rrezikut kreditor) dhe dobësim të kapacitetit kursyes (rritje e rrezikut të likuiditetit). Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik, rritja e normave të interesit për të luftuar inflacionin si dhe rritja potenciale e tarifave të energjisë pritet të kontribuojnë tutje në rritjen e rrezikut kreditor për sektorin bankar.

Grafik 16. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Grafik 17. Kontributi në rritje i asetëve të sistemit financiar, në pikë përqindje




Burimi: BQK.

Asetet

Asetet e sektorit bankar në vitin 2022 arritën vlerën 6.76 miliardë euro, që përkon me rritje të përshpejtuar vjetore prej 13.5 përqind krahasuar me rritjen 11.3 përqind në vitin paraprak (grafik 18). Kontributin kryesor në rritje e kishte zgjerimi i kreditimit si aktiviteti kryesor i sektorit. Bilanci me bankat tjera ishte komponenta e dytë radhazi për nga kontributi në përshpejtimin e rritjes së aseteve, përderisa zërat tjerë ngadalësuan ritmin rritës. Investimi në letra me vlerë ngadalësoi rritjen vjetore në 9.8 përqind nga 17.2 përqind në vitin paraprak. Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në po ashtu ngadalësoi rritjen, në 4.3 përqind nga 6.2 përqind në vitin paraprak.

Grafik 18. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Burimi: BQK.

Kreditimi

Aktiviteti kreditues i sektorit shënoi rritje vjetore prej 16.1 përqind, që përkon me shkallën më të lartë të rritjes në njëmbëdhjetë vitet e fundit. Sidoqoftë, tremujori i fundit i vitit u karakterizua me ngadalësim të trendit rritës. Sipas Anketës së Kreditimit bankar, dinamikat e kreditimit në tremujorin e fundit të vitit u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore nuk kishte ndryshime të rëndësishme nga tremujori paraprak. Kushtet dhe rregullat për kredi të ekonomive familjare përgjithësisht u shtrënguan (rritje e normës së interesit) gjatë vitit, por kërkesa megjithatë shënoi rritje për të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare- kreditë konsumuese dhe patundshmëritë. Nevoja për financim të inventarëve dhe kapitalit punues nga ndërmarrjet u reflektua me kërkesë të shtuar edhe nga ndërmarrjet, megjithëse në nivel më të ulët se pritjet.


Grafik 19. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 15.7 përqind, që përkon me përshpejtim të trendit vjetor të rritjes për 2.6 pikë përqindje (grafik 19). Ndërsa, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 16.7 përqind, që në krahasim me vitin paraprak paraqet ngadalësim të rritjes për 1.9 pikë përqindje. Rrjedhimisht, kontributi dominues që ka segmenti i korporatave jofinanciare në gjithsej rritjen e kreditimit të sektorit u rrit tutje (grafik 20).

Grafik 20. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje




Burimi: BQK.

Kreditë e reja gjatë vitit 2022 shënuan ngadalësim të trendit të rritjes në 6.5 përqind krahasuar me rritjen e theksuar prej 22.9 përqind në vitin 2021. Trendi i ngadalësuar u ndikua nga dinamikat e kredive të reja në tremujorin e katërt, i cili u karakterizua me rënie vjetore të kredive në dy segmentet – korporata jofinanciare dhe ekonomi familjare. Për dallim nga viti i kaluar që u karakterizua me rritje më të lartë të kredive të reja nga ekonomitë familjare, këtë vit rritja ishte më e theksuar për korporatat jofinanciare (grafik 21). Deri në dhjetor 2022, kreditë e reja të korporatave jofinanciare u rritën për 9.6 përqind. Rritja ishte lehtësisht më e lartë për kreditë investuese, 9.0 përqind, se për kreditë jo-investuese që u rritën për 7.8 përqind. Kreditë e reja për ekonomitë familjare shënuan rritje shumë më të ngadalësuar prej vetëm 2.4 përqind krahasuar me rritjen 45 përqind në vitin 2021. Kreditë e reja konsumuese shënuan rënie vjetore prej 6.3 përqind (rritje 40.3 përqind në vitin 2021), të ndikuar kryesisht nga rënia në tremujorin e katërt të vitit. Kreditë hipotekare shënuan përgjithësisht ngadalësim të trendit vjetor të rritjes në 13.5 përqind (rritje prej 56.5 përqind në vitin 2021), përkundër rritjes më të theksuar në tremujorin e katërt të vitit. Viti 2022 u karakterizua me rritje të përdorimit të produkteve kreditore si mbitërheqjet dhe linjat kreditore, si nga korporatat jofinanciare, ashtu edhe nga ekonomitë familjare.³

Në kuadër të kredive për korporatat jo financiare, sektori i tregtisë është më i kredituari ndër vite, pasuar nga ai i prodhimitarisë dhe i ndërtimitarisë, të cilët janë zgjeruar gradualisht në vitet e fundit duke rritur pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Deri në dhjetor 2022, kreditimi ndaj sektorit të prodhimitarisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare (grafik 22), si rezultat i rritjes së lartë vjetore prej 29.4 përqind (grafik 23).


Sektori i tregtisë shënoi rritje vjetore prej 10.3 përqind dhe ishte i dyti për nga kontributi në rritjen e kredive për korporatat jofinanciare. Sektori i ndërtimitarisë shënoi rritje të përsheptuar prej 21.1 përqind, përkundër

Grafik 21. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 22. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 23. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

³ Shënim nga departamenti i Statistikave: Nga muaji nëntor 2021 është përmirësuar kualiteti i raportimit të mbitërheqjeve dhe linjave kreditore.

sfidave me të cilat u përball ky sektor për shkak të rritjes së lartë të inflacionit – rritjes së çmimit të materialeve ndërtimore. Sektori i bujqësisë këtë vit u karakterizua me rritje pozitive prej 9.7 përqind, për dallim nga rënia e theksuar në vitin paraprak.

Kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, përkatësisht ndaj sektorit të prodhimit, është mbështetur edhe nga Pako e Ringjalljes Ekonomike, përmes masës së subvencionimit të kredive investive për bizneset prodhuese. Zbatimi i kësaj mase gjatë këtij vitit mund të ketë ndikuar në përshpejtimin e rritjes së kredive për këtë sektor.


1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake

Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet në depozitat e klientëve dhe kapitalit vetanak, konkretisht fitimit të mbajtur dhe fitimit të realizuar gjatë vitit aktual. Të dy këto zëra përbëjnë rreth 92.5 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit, ku 82.1 përqind janë vetëm depozitat. Pasiguritë e rritura si pasojë e presioneve inflacioniste dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik u reflektuan në sjelljen konsumatore përmes ngadalësimit të rritjes së depozitave të dy kategorive dominuese në strukturën e depozitave, ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare. Ky zhvillim, së bashku me rrethanat e reja të normave më të larta të interesit në nivel global si dhe rritjen e konkurrencës në tregun vendor, shtyu sektorin bankar të ofroj kushte më të favorshme për sigurimin e financimit – rritje të normës së interesit në depozita.

1.1.1 Depozitat


Vlera e stokut të depozitave në fund të dhjetorit 2022 arriti në 5.6 miliardë euro (grafik 24), që paraqet një rritje vjetore të përshpejtuar prej 13.3 përqind, nga 12.4 përqind në dhjetor 2021. Depozitat e dy segmenteve dominuese në strukturën e gjithsej depozitave - ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare - shënuan ngadalësim të rritjes, por rritja e lartë në depozitat e korporatave financiare, korporatave publike si dhe depozitave nga jorezidentët, përcaktuan trendin e përshpejtuar rritës të gjithsej depozitave.

Grafik 24. Stoku i gjithsej depozitave




Burimi: BQK.

Grafik 25. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 26. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

ngadalësim të rritjes, por rritja e lartë në depozitat e korporatave financiare, korporatave publike si dhe depozitave nga jorezidentët, përcaktuan trendin e përshpejtuar rritës të gjithsej depozitave.

Depozitat e ekonomive familjare shënuan ngadalësim të rritjes vjetore në 8.3 përqind nga 14.6 përqind në vitin paraprak, zhvillim ky që mund të jetë ndikuar nga shpenzimet më të larta të ekonomive familjare gjatë këtij viti si rezultat i rritjes së çmimeve, përderisa të ardhurat/pagat mbetën në nivel e njejtë ose u rritën në shkallë shumë më të ulët. Në dhjetor 2022, vlera e depozitave të ekonomive familjare arriti në 3.65 miliardë euro, dhe kontributi në rritjen e gjithsej depozitave mbeti më i larti nga kjo kategori (grafik 25). Sa i përket nivelit të depozitave të reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare, ku përfshihen vetëm depozitat e afatizuara, ato gjatë vitit 2022 arritën në vlerën prej 421.4 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind, përderisa vitin paraprak kishte rënie vjetore prej 24.0 përqind (grafik 26). Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së normave të interesit në depozita për këtë kategori, të cilat u rritën nga bankat në përpjekje për të mbajtur depozitat/financimin për mbështetjen e shkallës së lartë të kreditimit në vend, në rrethana të rritjes së kostos së financimit nga jashtë.

Stoku i depozitave të korporatave jofinanciare në fund të vitit 2022 arriti në 1.2 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 19.0 përqind - lehtësisht më të ulët se në vitin 2021 ku rritja ishte 19.3 përqind. Depozitat e reja të arkëtuara gjatë vitit nga ky segment u rritën në 356.2 milionë euro nga 106.2 milionë në vitin 2021. Ky zhvillim vlerësohet se është ndikuar nga rritja e normave të interesit, aktiviteti i shtuar ekonomik si dhe rrija e pasigurive rreth perspektivës ekonomike, që mund të ketë dekurajuar investimet.


1.2 Normat e interesit

Normat e interesit në kredi dhe depozita të reja kanë pësuar lëvizje në rritje, pas trendeve rënëse në vitet paraprake. Aplikimi i politikave të shtrënguara monetare në luftën kundër inflacionit kanë krijuar ambient me shkalla të rritura të interesit, situatë që është përcjellur edhe në tregun vendor. Transmetimi i ndryshimeve në normat bazë të interesit është reflektuar në të gjitha segmentet e tregut bankar e financiar por në nivele të ndryshme.


Në tregun bankar normat e interesit në depozitat e reja janë ndikuar në nivel më të lartë se normat e interesit në kredi të reja. Në dhjetor 2022, shkalla e interesit në kredi arriti në 6.3 përqind nga 5.8 përqind një vit më parë, dhe 6.0 përqind sa ishte në qershor 2022, atëherë kur inflacioni u intensifikua dhe diskutimet mbi ndërhyrjen e politikës monetare filluan. Poashtu shkalla mesatare e interesit në depozita u ngrit në 2.4 përqind nga 1.3 përqind një vit më parë dhe 1.9 përqind në shtator 2022, atëherë kur shqetësimet mbi ruajtjen e depozitave dhe rrjedhimisht rrezikun e likuiditetit u theksuan tutje. Margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 3.9 pikë përqindje nga 4.5 pikë përqindje (grafik 27).

Dinamika e normave të interesit e ndikuar nga zhvillimet në nivel global, si dhe rritja e rrezikut të likuiditetit dhe pasigurive mbi zhvillimet në të ardhmen si pasojë e rritjes së presioneve inflacioniste, përveç që kanë shtyer bankat në vend drejt rritjes së normave të interesit në kredi e depozita, në të njëjtën kohë kanë ndikuar edhe në ndryshimin e strukturës së kredive sipas llojit të normave të interesit. Përderisa në vitin e kaluar dhe në vitin 2020, kreditë me shkalla variable të interesit, që kryesisht përcaktohen nga lëvizjet e normës Euribor për marzhën shtesë, përbënin mesatarisht 19.6 përqind të portfolios kreditorë dhe 16.5 përqind respektivisht, kjo përbërje këtë vit është ngritur në 24.1 përqind. Poashtu, disa banka që kanë aplikuar vetëm shkalla fikse, këtë vit filluan aplikimin e normave variable (grafik 27a).

Grafik 27. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Grafik 27a. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit




Burimi: BQK.

Kjo dinamikë tregon për qasjen prudente që kanë adaptuar bankat për menaxhimin e rrezikut në rritje nga inflacioni, dhe zhvillimeve në të njëjtën kahje në nivel global. Pritjet janë që kjo pjesëmarrje si dhe rritja e normave të interesit të vazhdojë edhe në periudhat në vazhdim, mbështetur edhe nga deklaratimet e bankave në Anketën e Kreditimit bankar.

Grafik 28. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare




Grafik 29. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Shkalla mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në dhjetor 2022 qëndroi në 6.5 përqind, për 0.76 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë dhe 0.03 e 0.39 pikë përqindje më e lartë se në shtator dhe qershor 2022, respektivisht. Shkalla më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për segmentin e shërbimeve (6.4 përqind), ndërsa shkalla mesatare më e lartë e interesit ishte për sektorin e bujqësisë prej 7.6 përqind, për shkak të rrezikut më të lartë që bartin (grafik 28). **Shkalla mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare** arriti në 5.9 përqind, pothuajse e njëjtë me atë të një viti më parë.

Grafik 30. Normat e interesit për depozita



Normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare në mesatare prej 5.1 përqind, duke qenë se konsiderohen me rrezik pak më të ulët kur kanë mbulesë me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të kenë shkalla më të larta të interesit prej mesatarisht 6.4 përqind (grafik 29). **Normat e interesit në depozita** filluan trendin rritës që nga muaji qershor i vitit 2022 duke arritur deri në

mesatarisht 2.4 përqind në fund të vitit. Shkalla mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare u rritën për 0.5 pikë përqindje, në 2.5 përqind, përderisa për ekonomitë familjare u rritën për më shumë 0.9 pikë përqindje, duke arritur në 1.8 përqind (grafik 30).


Performanca e sektorit bankar

Sektor i bankar përmbylli vitin 2022 me fitim neto prej 140.3 milionë euro, vlera më e lartë e realizuar që nga themelimi i sektorit bankar. Rezultati i tillë financiar u mundësua nga rritja më e lartë e të hyrave krahas rritjes së shpenzimeve (grafik 31). Po ashtu tremujori i katërt rezultoi në këtë performancë më të mirë financiare krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, por deri në një masë më të dobët se në tremujorin e dytë dhe të tretë të këtij viti.

Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 370.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.0 përqind (15.4 përqind një vit më parë). Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 71.1 përqind të gjithë të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në kredi kontribuuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit. Për më tepër, këtë vit, të hyrat nga interesi prej plasmanëve në bankat tjera dhe nga investimet në letra me vlerë janë rritur theksueshëm krahasuar me rënien me vitin paraprak. Ndërsa, kategoria e të hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje shumë më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, 8.0 përqind nga 31.0 përqind sa ishte deri në dhjetor 2021, dhe arritën vlerën prej 92.7 milionë euro.


Me rritje u karakterizuan edhe shpenzimet e sektorit, që shënuan rritje më të lartë vjetore kundrejt vitit paraprak prej 12.4 përqind nga 2.6 përqind, dhe arritën vlerën prej 230.0 milionë euro. Kontributin në këtë diferencë e kishte rritja vjetore prej 12.1 përqind apo 14.6 milionë euro e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative që kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit për 16.3 përqind (apo për 8.4 milionë euro). Kjo rritje sugjeron presionin e inflacionit në korrigjim të pagave të punonjësve në sektorin bankar. Poashtu, kategoria e shpenzimeve të jo-interesit shënoi rritje krahas rënies në vitin paraprak, për shkak të rritjes së shpenzimeve për tarifa dhe komisione si dhe provizioneve për humbjet e kredive (17.1 përqind rritje apo 2.5 milionë euro rritje).

Grafik 31. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Grafik 32. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmeria me provizione



Burimi: BQK.

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ndër vite ka arritur të siguroj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo performuese. Gjendja e kënaqshme e këtyre indikatorëve i jep përparësi sektorit në absorbimin e goditjeve nga pasiguritë e shkaktuara nga krizat gjeopolitike, rritja e inflacionit dhe ngadalësimi ekonomik.


Cilësia kreditore shënoi përmirësim duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2021 deri në shtator të këtij viti, ku vlera e kredive jo-performuese kishte trend rënës prej mesatarisht 2.5 përqind. Në tremujorin e fundit të vitit 2022, trendi rënës ndërroi kahje, ku vlera e KJP-ve u rrit për 4.4 përqind. Përderisa vlera e kredive jo-performuese për ekonominë familjare ka rënë për 3.9 përqind, ishte portfolio kreditore e ndërmarrjeve që pësoi rritje vjetore të vlerës së KJP-ve prej 6.1 përqind dhe ndikoi në rritjen e KJP-ve në tremujorin e fundit të vitit. Rritja e vlerës së KJP-ve ishte më e theksuar në sektorët që kanë përdorim më të lartë të energjisë dhe rrjedhimisht ishin më të ndjeshëm ndaj zhvillimeve në tregun e energjisë (sektori i prodhimitarisë që shënoi rritje të vlerës së KJP-së prej 11.4 përqind, patundshmërisë dhe ndërtimtarisë 7.5 përqind, dhe tregtisë 4.5 përqind)⁴. Përballja me rritje të çmimeve të energjisë dhe shpenzimeve për të gjetur alternativa të energjisë nën pasigurinë e reduktimeve të mundshme e vështirësive në furnizime, mund të ketë ndikuar në aftësinë ripaguese të disa ndërmarrjeve.

Rritja më e theksuar e kreditimit në periudhën raportuese ndikoi që raporti i kredive joperformuese të zvogëlohet në 2.0 përqind, nga 2.1 përqind në shtator 2022 dhe 2.3 përqind në dhjetor 2021. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëlua lehtësisht në 149.7 përqind, nga 151.0 përqind dhe 150.6 përqind në shtator 2022, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese se sa i vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (grafik 32).

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit zbriti në nivelin prej 14.8 përqind nga 16.4 përqind në dhjetor 2021, rezultat i rritjes më të theksuar të aseteve me peshë rreziku ndikuar nga rritja e lartë e kreditimit. Poashtu, në krahasim me tremujorin paraprak, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivel më të ulët, si pasojë e zvogëlimit të kapitalit dhe rritjes së aseteve me peshë rreziku (grafik 33).


Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra zbriti në nivel prej 36.5 përqind, nga 37.2 përqind (grafik 34). Rënia e nivelit të likuiditetit krahasuar me një vit më parë është rezultat

Grafik 33. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Grafik 34. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

⁴ Për më tepër referojuni pjesës së kreditimit më lartë.


i rritjes së detyrimeve afatshkurtëra prej 9.0 përqind krahas rritjes së mjeteve likuide prej 7.0 përqind. Në kuadër të mjeteve likuide, investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja shënuan rritjen më të theksuar, dhe po ashtu ndikim pozitiv në rritjen e mjeteve likuide patën edhe depozitat dhe plasmanët në bankat e huaja. Ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur rezultat i depozitave të rritura posaçërisht përgjatë tremujorit të fundit të vitit. Ndërsa në raport me tremujorin paraprak niveli i likuiditet është rritur për shkak të rritjes më të lartë prej 7.5 përqind të mjeteve likuide krahas rritjes së detyrimeve afatshkurtra prej 3.4 përqind. Raporti kredi/depozitë është ngritur në 78.3 përqind nga 76.5 përqind një vit më parë, rezultat i rritjes më të lartë të kreditimit përgjatë këtij viti. Ndërsa ky nivel ishte më i lartë se në tremujorin paraprak, për shkak se rritja ishte më e lartë e depozitave, në nivelin prej 5.6 përqind krahasuar me rritjen e kreditimit prej 2.8 përqind (nga shtator deri në dhjetor).

Sektori pensional

Asetet e sektorit pensional shënuan ngadalësim më të theksuar të rritjes dhe rënie të vlerës së investimeve krahasuar me një vit më parë, pasojë e zhvillimeve jo të favorshme makroekonomike që kanë afektuar njëkohësisht turbulencat e tregjeve financiare.

Me pjesëmarrjen e dytë më të lartë në gjithsej asetet e sistemit financiar, asetet e fondeve pensionale u rritën me 2.4 përqind, por që ishte shumë më e ngadalësuar se në vitin paraprak prej 18.2 përqind. Vlera e aseteve pensionale arriti në 2.42 miliardë euro, nga të cilat 99.6 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), dhe pjesa e mbetur nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja). Përderisa FKPK-ja shënoi rritje të aseteve prej 2.5 përqind, asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-ja) shënuan rënie prej 9.4 përqind. (grafik 35).


Grafik 35. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Asetete FKPK-së kryesisht janë të investuara në tregun e jashtëm (70.2 përqind e portfolios investuese), në fonde të përbashkëta në vlerë prej 1.7 miliardë euro (apo 70.0 përqind e gjithsej aseteve të FKPK-së), dhe pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 553.8 milion euro apo 23.0 përqind e gjithsej portfolios investuese dhe certifikata të depozitit në sektorin bankar vendor në vlerë prej 136.9 milionë euro (5.7 përqind e gjithsej investimeve). Po ashtu edhe struktura e portfolios investuese e FSKP-ës është e ngjashme me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, në forme të aksioneve që përbëjnë 69.1 përqind të portfolios investuese, dhe në nivel marginal në letra me vlerë 5.4 përqind e investimeve. Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përbëjnë 15.7 përqind të gjithsej portfolios investuese.

Grafik 35a. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP.

Që të dy fondet pensionale u karakterizuan me zvogëlim të portfolios investuese në tregun e jashtëm krahas rritjes së investimeve në atë të brendshëm, duke


qenë të afektuara nga luhatjet negative që kanë prekur tregjet financiare. Në këtë kontekst për FKPK-në rritje të theksuar kishin certifikatat e depozitit dhe bilanci/paraja e gatshme me BQK-në, të cilat kategori ishin në rënie në vitin paraprak, ndërsa letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës vazhduan rritjen prej 12.7 përqind nga rritja 9.0 përqind një vit më parë (grafik 35a).

Përderisa vlera e kontributeve të arkëtuara shënoi rritje në të dy fondet pensionale, performanca e fondeve pensionale përgjatë vitit ishte e dobët krahasuar me vitin paraprak, pas rënies së vlerës së investimeve deri në tremujorin e tretë të vitit ku rrethanat e pafavorshme gjeopolitike dhe presionet inflacioniste në rritje shkaktuan destabilizim të tregjeve dhe vështirësuan gjendjen e investimeve. Megjithatë ndryshimi filloj të ndodhë në tremujorin e katërt të këtij viti, me realizimin e kthimeve pozitive të investimeve nga të dy fondet pensionale.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja për tërë vitin 2022 arriti në 608.4 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.3 përqind, e ndikuar nga rritja e numrit të kontribut-dhënësve. Kurse, kthimi kumulativ bruto nga investimet për vitin 2022 ishte në vlerë negative prej 788.6 mijë euro (kthim pozitiv në vitin 2021 në vlerë 1.1 milionë euro). Megjithatë tremujori i katërt i vitit kishte performancë të mirë, e cilësuar me rritje të vlerës së investimeve, në nivelin prej 106.7 mijë euro për dallim nga tremujori i tretë ku investimet kishin vlerë negative prej 93.7 mijë euro dhe tremujori i dytë që kishte kthim edhe më të thellë negativ prej 505.8 mijë euro.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja për vitin 2022 shënoi rritje vjetore prej 13.1 përqind, duke arritur në 241.5 milionë euro. Përkundër situatës së rënduar gjeopolitike dhe presioneve në aktivitetin ekonomik nga politika të shtrënguara monetare në luftën ndaj inflacionit, investimet e FKPK-së në tremujorin e katërt arritën të rikthehen në territor pozitiv të vlerës së investimeve, nga kthimet negative të shënuara në të tri tremujorët paraprak. Rrjedhimisht viti 2022 në vlerë kumulative ka kthim negativ prej 119.7 milionë euro (kthim pozitiv 228.4 milionë euro në vitin 2021). Mirëpo tremujori i katërt u cilësua më rritje të vlerës së investimeve në gjithsej nivelin prej 51.6 milionë euro, për dallim nga kthimi negativ në tremujorin paraprak 8.7 milionë euro dhe tremujorin e dytë 101.1 milionë euro (grafik 36). Politika investuese e fondeve kërkon diversifikim të investimeve dhe synon kthim pozitiv në afat të gjatë, duke mbajtur njëkohësisht edhe një portofolio të ashtuquajtur 'konzervativ' mjetet e të cilit përfaqësohen nga kontribuesit që janë afër pensionimit, që me qëllim të mbrojtjes së vlerës së mjeteve, këto investohen në afat më të shkurtër dhe me kthim pozitiv të sigurt – siç janë investimet në letra me vlerë të Kosovës.

Grafik 36. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit për të katërtin vit me radhë; përkundër zhvillime jo të favorshme politike, ekonomike dhe financiare që mbizotëruan gjatë 2022.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.7 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar në fund të vitit 2022. Vlera e gjithsej asetëve në fund të periudhës arriti në 267.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 11.2 përqind, duke vazhduar trendin e rritje dyshifrore në vitet e fundit (grafik 37). Zgjerimi i sektorit kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së rezervave teknike, që burojnë nga primet e shkruara, si dhe kapitalit vetanak (kapitalit aksionar dhe fitimit të realizuar). Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e

depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje, por më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, si rezultat i nivelit më të ulët të borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës

Vlera e primeve të shkruara në vitin 2022 arriti vlerën prej 134.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.1 përqind. Rritja e primeve të shkruara reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të kategorisë ‘aksidenti dhe shëndeti’ në kuadër të sigurimit vullnetar. Kurse, primet e shkruara ndaj sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më madhe, prej 58.9 përqind të gjithsej primeve të shkruara jo-jetë. Rritja e primeve në kuadër të sigurimit ‘aksidenti dhe shëndeti’ (për 29.3 përqind) është sinjal pozitiv për rritje të numrit të qytetarëve që posedojnë sigurimi shëndetësor. Përderisa, rritja e primeve të sigurimit të detyrueshëm reflekton kryesisht kategorinë e ‘sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive - MTPL’, që shënuan rritje për 5.4 përqind.


Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e

Sigurimeve në vitin 2022 arriti vlerën prej 64.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.4 përqind (24.4 përqind një vit më parë) (grafik 38). Vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja ka shënuar rënie prej 13.3 përqind, kurse dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind. Sektori i sigurimeve në vitin 2022 shënoi fitim në vlerë prej 3.5 milionë euro (6.3 milion euro një vit më parë). Zvogëlimi i fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve operative, përkatësisht kostos së blerjes së mallrave dhe shërbimeve (ndikuar nga presionet inflacioniste në vitin 2022), shpenzimeve administrative (kryesisht kompensimit për punëtor) dhe dëmeve të ndodhura.

Sektori mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar në vitin 2022 shënoi rritje të përshpejtuar të aseteve, kryesisht ndikuar nga zgjerimi i kreditimit dhe lizingjeve, që u financuan nga huatë e marra nga sektori i jashtëm. Rezultati financiar tejkaloi nivelin e vitit të kaluar, dhe është më i larti që nga konsolidimi i sektorit mikrofinanciar, ndikuar nga rritja më e lartë e të hyrave kundrejt shpenzimeve. Indikatorët e shëndetit financiar janë në nivel optimal dhe janë përmirësuar krahasuar me një vit më parë; duke sinjalizuar stabilitet në këtë sektor. Sidoqoftë, sektori mund të përballet me kosto të rritura të financimit për shkak të rritjes së normave bazë të interesit si pjesë e politikës monetare të aplikuar nga një pjesë e madhe e vendeve të huaja për menaxhimin e inflacionit. Këto dinamika, mund të reflektohen në rritje të normave të interesit për kredi,

Grafik 37. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Grafik 38. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

për shkak të varësisë së madhe në financim të aktivitetit nga huatë e jashtme (61.1 përqind të detyrimeve dhe kapitalit).

Asetet


Asetet e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 18.1 përqind në dhjetor 2022, duke arritur vlerën prej 401.7 milionë euro në fund të periudhës (grafik 39). Në këtë rritje kontributin kryesor e kishte rritja e kreditimit (71.5 përqind të aseteve) dhe në masë më të ulët rritja e lizingjeve; të cilat u karakterizuan me rritje dyshifrore në dy vitet e fundit. Aktiviteti kreditor i sektorit vazhdon të mbështetet nga huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit të cilat u rritën për 21.1 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, kryesisht përmes fitimit të bartur ndër vite dhe atij të realizuar gjatë vitit 2022, komponentë që u rritën për 31.9 dhe 22.2 përqind, respektivisht.

Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar shënoi rritje të përshpejtuar në vitin 2022 dhe kthyer trendin e rritjes ngjashëm me vitet para shpërthimit të pandemisë (2015-2019).


Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje për 20,1 përqind në vitin 2022, përdërisa stoku i tyre arriti në 287.3 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy segmentet ekonomik, korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare.

Grafik 39. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 40. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare




Burimi: BQK.

Grafik 41. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Grafik 42. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Konkretisht, kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 16.6 përqind (rritje vjetore 16.7 përqind në vitin 2021), duke arritur vlerën 182.4 milionë euro në fund të dhjetorit 2022 (grafik 40). Stoku i kredive ndaj korporatave jo financiare arriti vlerën prej 104.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 26.9 përqind (rritje për 17.8 përqind në dhjetor 2021).

Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare sipas sektorëve të ekonomisë ka ndjekur trendin e përgjithshëm, duke shënuar rritje në secilin segment (grafik 41). Për dallim nga sektori bankar, stoku i kredive ndaj segmentit të bujqësisë ka peshën më të madhe në gjithsej kreditimin për korporatat jofinanciare të IMF/IFJB-të prej 25.8 përqind. Për më tepër, ky segment kishte kontributin e dytë më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit ndaj korporatave jofinanciare (grafik 42), duke shënuar rritje vjetore prej 26.0 përqind në vitin 2022 dhe arritur vlerën prej 27.0 milionë euro. Në rritjen e kreditimit për segmentin e bujqësisë ndikim kishte edhe garancia e ofruar nga FKGK-ja për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të. Krahasuar me një vit më parë, shumën e miratuar të kredive nga FKGK-ja arritin në 506.3 milionë euro, apo për 23.9 përqind më shumë se një vit më parë. Si rrjedhojë e garancive prej FKGK-së, IMF-të i janë përgjigjur pozitivisht kërkesë për kredi për këtë sektor që ka rrezik më të lartë, për shkak të varshmërisë së madhe nga kushtet klimatike dhe rrezikut nga fatkeqësitë natyrore. Po ashtu, me rritje dyshifrore gjatë kësaj periudhe u karakterizuan edhe segmenti i industrisë, ndërtimitarisë dhe tregtisë, ngjashëm me trendin e rritjes së kreditimit prej sektorit bankar. Kreditimi ndaj segmentit të shërbimeve tjera, kishte kontributin dhe rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe

Grafik 43. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Lizingjet

Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar (18.4 përqind). Aktiviteti i lizingjeve për të dytin vit me radhë shënuan rritje dyshifrore, dhe arritën vlerën në 73.7 milionë euro në fund të vitit 2022 (grafik 43). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor vazhdojnë të kenë korporatat jofinanciare, përderisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i limituar.

Normat e Interesit

Shkalla mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në dhjetor 2022 ishte 18.6 përqind, për 0.8 pikë përqindje më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 44). Për dallim nga sektori bankar, që ka shkalla pothuajse trefish më të ulëta për shkak të kostos së ulët të financimit të aktiviteteve (përmes depozitave), IMF/IFJB-të kryesisht financohen nga kreditë e marra nga sektori i jashtëm, që kanë shkalla më të larta të interesit. Zhvillimet e fundit në sektorin financiar, përkatësisht rritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore, pritet të reflektohet në koston e financimit të sektorit dhe potencialisht, të përkthehet në rritje të normës së interesit të ofruar nga ky sektor.

Grafik 44. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Shkalla e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi ulje për 0.2 pikë përqindje, në 20.7 përqind. Sipas llojit të kredive, për kreditë konsumuese, shkalla mesatare e interesit u rrit për 0.5 pikë përqindje në 22.4 përqind. Kurse, kreditë hipotekare vazhdojnë të kenë normat më të ulëta të interesit, në mesatare prej 17.3 përqind në dhjetor 2022, një rënie vjetore prej 1.3 pikë përqindje.

Për korporatat jofinanciare, normat mesatare të interesit, në bazë vjetore u zvogëluan për të gjitha veprimtaritë ekonomike, me theks të veçantë për sektorin e shërbimeve (grafik 45). Shkalla e interesit për kreditë për sektorin e bujqësisë dhe atë të industrisë u zvogëluan për 1.7 dhe 1.9 pikë përqindje përkatësisht, duke qëndruar në 17.3 përqind në dhjetor 2022. Kurse, kreditë ndaj sektorit të shërbimeve kishin normën më të ulët të interesit, prej 13.8 përqind, rënie vjetore për 2.1 pikë përqindje. Në rënie në normës së interesit për kreditë ndaj sektorit të bujqësisë në vitet e fundit rol kishte edhe garantimi i kredive prej FKGK-së,

Performanca e sektorit mikrofinanciar


Sektorin mikrofinanciar në vitin 2022 arriti të shënoj fitim neto në vlerë prej 17.2 milionë euro, duke regjistruar njëherit edhe nivelin më të lartë të fitimit të realizuar prej fillimit të operimit në tregun vendor (grafik 46).

Rritja më e theksuar a të hyrave (14.9 përqind) kundrejt nivelit të rritjes së shpenzimeve (12.0 përqind) të sektorit ka ndikuar që IFM/IFJB-të të realizojnë fitim më të lartë për 3.1 milionë euro krahasuar me një vit më parë.

Në kuadër të hyrave, të hyrat nga interesi, që paraqesin kategorinë dominues të hyrave (89.8 përqind), shënuan rritje vjetore prej 15.9 përqind (rritje për 3.0 përqind në vitin 2021), si rezultat i rritjes së theksuar të kreditimit në dy vitet e fundit. Kategoria e të ardhurave nga jointerisi në vitin 2022 shënuan rritje për 7.2 përqind, por që kontributi i tyre në rritjen e gjithsej të hyrave ishte i limituar për shkak të peshës së ulët në gjithsej të hyrat (10.1 përqind).


Në kuadër të shpenzimeve, kategorinë e shpenzimeve të jointerisit, rritja e evidentuar kryesisht i'u atribuua shpenzimeve të personalit dhe administrative. Kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 18.3 përqind (7.7

Grafik 45. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.


Grafik 46. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

*Vlera për shtator 2022 është anualizuar

Grafik 47. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK.

përqind një vit më parë), e që mund ti atribuohet rritjes së shpenzimeve për punëtorë, dhe në masë më të ulët atyre administrative. Për më tepër, rritja e numrit të personelit si dhe rritja e pagave për të kompensuar deri në një masë inflacionin e lartë që ka mbizotëruar në pjesën më të madhe të vitit 2022, kanë kontribuar në rritje të kësaj nënkategorie të shpenzimeve të jointerestit. Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit (21.7 përqind të gjithë shpenzimeve) shënoi rritje vjetore prej 5.6 përqind në vitin 2022 (-37.0 përqind një vit më parë), duke reflektuar rritjen e nivelit të huazimeve prej sektorit të jashtëm. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithë kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.6 pikë përqindje, në 1.8 përqind. Përderisa, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në dhjetor 2022 është rritur në 153.2 përqind (141.6 përqind në vitin 2021) (grafik 47).

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës


Emetimi i letrave me vlerë qeveritare deri në dhjetor 2022 ishte dukshëm më i ulët se në vitin paraprak, përderisa kërkesa për të investuar në letra me vlerë ka vazhduar të tejkalojë ofertën e qeverisë. Në linjë me rritjen e maturitetit të emetimeve, është rritur edhe shkalla mesatare e interesit, e cila ndër tjerash reflekton ngushtimin e raportit kërkesë/ofertë si dhe tendencës në nivel global në fund të vitit.

Grafik 48. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.


Grafik 48a. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Deri në dhjetor të vitit 2022, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 223.8 milionë euro, për 24.5 përqind më pak se një vit më parë (grafik 48). Ndërsa, kërkesa për të investuar, në mungesë të alternativave investuese për diversifikim të mjeteve, vazhdimisht ka tejkaluar ofertën megjithëse ky raport ishte më i ulët se në vitin paraprak. Kërkesa për letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.39 herë më e lartë se sa shumës e ofruar nga Qeveria, ndërsa në vitin paraprak ishte për 1.63 herë më e lartë. Rënia e raportit reflekton rënien më të theksuar të kërkesës për 37.8 përqind krahasuar me vitin paraprak dhe poashtu të ofertës nga Qeveria apo shumës së shpallur që ishte për 27.1 përqind më e ulët (grafik 48a). Investuesit kryesor në borxhin e qeverisë në formë të letrave me vlerë janë fondet pensionale, që këtë vit kanë rritur pjesëmarrjen në gjithë borxhin e qeverisë në 49.0 përqind nga 44.0 përqind në vitin 2021, ndërsa bankat komerciale kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 25.0 përqind nga 29.0 përqind.

Grafik 49. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Bankat mund të kenë ulur kërkesën për letra me vlerë në periudhën kur kreditimi ishte në nivel relativisht më të lartë. Shkalla mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 ishte 2.9 përqind,

rritje për 0.9 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e normës së interesit reflekton ndër tjerash konkurrencën, gjegjësisht ngushtimin e raportit kërkesë/ofertë. Struktura e letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës ndër vite ka pësuar ndryshime graduale drejt emetimit të letrave me vlerë me afat më të gjatë maturimit. Në periudhën Janar-Dhjetor 2022, struktura u dominua me 48.0 përqind nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitet prej '5 viteve', për dallim nga viti paraprak ku mbizotëroni emetimi i fletë-obligacioneve me maturitet prej '3 viteve' me pjesëmarrje prej 43.1 përqind (grafik 49).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 41, TM4 2022, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin [Economic Bulletin Issue 6, 2022 \(europa.eu\)](http://europa.eu)

IMF (FMN): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

World Bank: Commodity Markets: [Commodity Markets \(worldbank.org\)](http://worldbank.org)